

Trumpi thotë se ShBA-ja
fitoi, por lufta kundër
Iranit do të vazhdojë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË PARASHIHET NË STRATEGJINË E MIRATUAR PËR ZGJERIMIN E BE-së? PËR KOSOVËN PËRMENDET RËNDËSIA E DIALOGUT



Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2022, mirëpo aplikimi i saj nuk është shqyrtuar ende. Kështu, ajo është e vetmja në Ballkanin Perëndimor që

nuk e gëzon statusin e vendit kandidat. Kur përmendet Kosova në raport, aty theksohet rëndësia e dialogut të saj me Serbinë për avancim në rrugën drejt anëtarësimit

AKTUALE



**SHQIPËRI: KUVENDI VOTON
KUNDËR HEQJES SË IMUNITETIT
TË BALLUKUT, OPOZITA
PARALAJMËRON PROTESTË TË RE**

F. 2


KQZ-ja PEZULLON AKR-në

F. 5

**NË 45-VJETORIN E PROTESTAVE
STUDENTORE TË '81-S, KURTI
VIZITON VEPRIMTARIN MEHMET
HAJRIZI**

F. 7

EKONOMI



**MINISTRI HOTI PREMTON
MBËSHETJE PËR PUNËTORËT
PRIVATË DHE SINDIKATAT**

F. 8

**AUTORIZOHET PAGESA E
SUBVENCIONEVE TË MBETURA
BUJQËSORE PËR VITIN 2025**

F. 8

SPORT



**ADEMI TAKON MINISTRIN E
SPORTIT, VLERËSOHET PUNA E
FFK-së DHE SUKSESET E ARRITURA**

F. 11



**INSTITUTI
"RIINVEST" JEP
REKOMANDIME
PËR INTEGRIM
MË TË SHPEJTË
NË BE**

F. 3

**ARSYET
PRAPA
PËRÇARJES
OSMANI -
KURTI**

F. 6



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI THOTË SE SHBA-ja FITOI, POR LUFTA KUNDËR IRANIT DO TË VAZHDOJË

WASHINGTON, 12 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump ka pretenduar se Shtetet e Bashkuara e kanë “fituar” luftën kundër Iranit, por forcat ushtarake amerikane do t'i vazhdojnë sulmet derisa të përfundojë e gjithë puna. Ndërkohë, Teherani vazhdon të godasë anije në rajon dhe zotohet për sulme të tjera. “Asnjëherë nuk parapëlqehet të thuhet shumë herët se fituam. Ne fituam. Qysh në orët e para”, ka thënë Trumpi në një tubim të mbajtur në Kentaki më 11 mars. Komentet prej Trumpit dhe Shtëpisë së Bardhë kanë qenë të ndryshme ditët e fundit - prej spekulimeve që lufta do të zgjaste katër deri në gjashtë javë, deri te mundësia që mund të përfundojë “shpejt”. Trumpi ka thënë se sulmet amerikano-izraelite në Iran, që kanë nisur më 28 shkurt, “virtualisht kanë shkatërruar” këtë shtet të Lindjes së Mesme, duke ia vrarë një pjesë të konsiderueshme të udhëheqësisë dhe duke ia dëmtuar forcat e armatosura e programin bërthamor. Megjithatë, presidenti dhe të tjerë në administratën e tij kanë dhënë sinjale se nuk do të lëshojnë pe kur vjen puna te sulmet. “Nuk duam të largohemi herët, apo jo?

Na duhet ta përfundojmë punën”, ka thënë Trumpi. Izraeli e ka bërë të qartë se nuk është gati t'i japë fund fushatës ushtarake, përfshirë sulmet në Liban kundër forcave të Hezbollahut - aleatë të Iranit - duke thënë se “një mori shënjestrash” vazhdojnë të ekzistojnë. Hezbollahu është organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi të tjera. “Ne do ta zgjerojmë operacionin tonë”, ka thënë zëdhënësi ushtarak izraelit, Effie Defrin më 11 mars. Në orët e hershme të 12 marsit ushtria izraelite ka bërë me dije për “një valë të zgjeruar sulmesh në Teheran - njoftime pothuajse të përditshme në ditët e fundit.

Sulmet ndaj marinës iraniane

Trumpi ka thënë se forcat amerikane kanë goditur anije iraniane në Ngushticën e Hormuzit teksa rriten shqetësimet se Teherani mund të mendojë ndonjë fushatë të përdorimit të minave nënujore në njërin prej rrugëve detare më të rëndësishme në botë. “Ne goditëm 28 anije minash deri më tani”, u ka thënë Trumpi

gazetarëve, një ditë pasi ushtria amerikane ka bërë me dije se i ka shkatërruar 16 sosh. Mediet “Reuters” dhe CNN, duke cituar burime amerikane, kanë thënë se Irani ka vendosur dhjetëra mina në Ngushticë. “Reuters” e ka cituar një burim të ketë thënë se minat janë vendosur “ditë te fundit” dhe që shumica e lokacioneve dihen. Duke qenë se bota rrezikon të përballet me krizë energjetike, për shkak të problemeve në qarkullim të anijeve në rajonin e Gjirit, liderët perëndimorë kanë nisur të marrin vendime për ta parandaluar rritjen e madhe të çmimeve. Më 11 mars Trumpi ka thënë se Shtetet e Bashkuara do ta lëshojnë një sasi të rezervave strategjike të naftës për ta shtensionuar situatën. Departamenti Amerikan i Energjisë ka bërë me dije më vonë se do të lëshojë 172 milionë fuçi naftë, në koordinim me 32 shtete të tjera që i përkasin Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë. Kjo agjenci ka thënë se vendet anëtare janë pajtuar në mënyrë unanime që t'i lëshojnë 400 milionë fuçi naftë prej rezervave emergjente. Grupi i shtatë shteteve më të industrializuara (G7) e ka lëshuar një deklaratë duke thënë se vendet anëtare janë pajtuar që ta



shqyrtojnë mundësinë e shqërrimit të anijeve që kalojnë në rajonin e Gjirit, përfshirë Ngushticën e Hormuzit. G7 përbëhet nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Japonia, Italia, Britania, Gjermania dhe Franca.

Fati i liderit të ri suprem

Ndërkohë, zyrtarët iranianë janë duke zhvilluar një fushatë intensive për t'i hedhur poshtë thashethemet për gjendjen shëndetësore të liderit të ri suprem, Mojtaba Khamenei, duke thënë se ai është plagosur në sulmet ajrore që e lanë të vrarë babanë e tij dhe anëtarë të tjerë të familjes, por që ai vetë është “në gjendje të mirë”. Mojtaba Khamenei është emëruar lider i ri suprem i shtetit

më 8 mars, pas vrasjes së babit të tij në bombardimet e nisura më 28 shkurt. Ky 56-vjeçar nuk është parë në publik prej kur ShBA-ja dhe Izraeli i kanë nisur sulmet ajrore ndaj ranit, dhe as nuk ka bërë ndonjë deklaratë publike, duke rritur spekulimet se edhe ai mund të ketë vdekur ose është plagosur rëndë. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara i ka dënuar më 11 mars sulmet e Teheranit në shtetet e Gjirit dhe shtete të tjera në rajon. Rusia dhe Kina kanë abstenuar kur ka nisur votimi. Rezoluta kërkon “ndalje të menjëhershme të të gjitha sulmeve të Republikës Islamike kundër Bahrejnit, Kuvajtit, Omanit, Katarit, Arabisë Saudite, Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Jordanisë”.

SHQIPËRI: KUVENDI VOTON KUNDËR HEQJES SË IMUNITETIT TË BALLUKUT, OPOZITA PARALAJMËRON PROTESTË TË RE

TIRANË, 12 MARS - Kuvendi i Shqipërisë ka votuar të enjten kundër heqjes së imunitetit të ish-zëvendëskryeminstres Belinda Balluku pasi prokurorët kishin kërkuar autorizim për arrestimin e deputetes, e cila dyshohet për korrupsion. Deputetët e partisë në pushtet të kryeministrit Edi Rama me 82 votat e tyre pamundësuan heqjen e imunitetit të Ballukut, duke nxitur protestë nga deputetët opozitarë brenda sallës së Kuvendit. Për heqjen e imunitetit të Ballukut, e cila u shkarkua nga Rama ditë më parë, nevojitej një shumicë e thjeshtë prej 71 votash. Derisa diskutimi dhe votimi po ndodhte brenda Kuvendit, një numër protestuesish u mblodhën pranë ndërtesës duke iu përgjigjur thirrjes së liderit të Partisë Demokratike në opozitë, Sali Berisha. Duk folur para tyre, Berisha njoftoi se një protestë tjetër do të mbahet më 22 mars, dhe theksoi se ajo do të jetë “një kryengritje paqësore deri në fitore”. Kryeministri Rama e mbështeti vendimin, duke thënë se Kuvendi “me plot të drejtë refuzoi heqjen e



lirisë së një deputeteje në mungesë të plotë të kushteve për ta ndërmarrë një hap të tillë ekstrem”. Ai shkroi në X se shumica e tij qeverisëse e bëri sot “pa asnjë diskutim atë që do të bënte çdo parlament demokratik i Evropës, ku kalimi i kërkesave të prokurorisë jo për arrestin pa gjyq të një deputeti si kjo kërkesa e sotme, po për të filluar apo jo hetimet, nuk është askund si kalimi pa asnjë lloj kontrolli i kufijve në zonën Shengen”. “Ai është një proces serioz, i bazuar në norma kushtetuese e ligjore, të cilat nuk janë as karta bianka, as dyer të mbyllura për prokurorinë”, shtoi ai. Pas votimit, Ambasada e

Gjermanisë në Tiranë tha se Gjermania e mbështet procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në përputhje me dëshirën e shqiptarëve, por shtoi se “kusht i domosdoshëm për të përparuar në këtë proces të bazuar në merita është ndjekja penale me efektivitet e korrupsionit edhe në raste të rangut të lartë”. “Pritshmëria jonë e qartë është që edhe në këto raste ndjekja penale përmes drejtësisë të mund të realizohet shpejt dhe pa pengesa. Prej politikës shqiptare vazhdon të kërkohej ende që ta garantojë këtë proces”, thuhet në deklaratë. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të

Organizuar (SPAK) i kishte kërkuar Kuvendit qysh më 16 dhjetor të vitit të kaluar t'ia hiqte imunitetin Ballukut. SPAK ka ngritur aktakuzë kundër Ballukut për “shkelje të barazisë me tenderë” në rastin që ka të bëjë me procedurën e prokurimit për ndërtimin e tunelit të Llogorasë. Atëbotë ajo e mbante pozitën e zëvendëskryeminstres dhe ministres së Transportit dhe Energjetikës. Balluku është nën hetime edhe për shtatë procedura të tjera prokurimi që lidhen me disa projekte infrastrukturore në Tiranë. Më 26 shkurt të këtij viti kryeministri Edi Rama e shkarkoi Ballukun nga postet qeveritare. Partia Socialiste është kundër arrestimit të Ballukut, duke argumentuar se ajo nuk mund t'i prishë provat apo të arratiset, nuk mund të përsërisë veprën penale, dhe rruga e SPAK-it për ta hetuar atë është e hapur. Partia Demokratike opozitare ka deklaruar se imuniteti nuk duhet të kthehet në mburojë apo pengesë për drejtësinë. Ndërsa në Kuvend po mbante seancë, jashtë tij ishin mbledhur

protestues të thirrur nga opozita. Protestuesit kërkonin dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. Forca të shumta policie u rreshtuan para oborrit të Kuvendit për ta mbikëqyrur situatën. Prej kur SPAK-u ngriti aktakuzë kundër Ballukut, opozita ka zhvilluar disa protesta, në të cilat ka pasur tensione, dhunë dhe të lënduar si nga ana e protestuesve ashtu edhe nga ana e policisë. Para se të niste seanca për ta shqyrtuar kërkesën e SPAK-ut, Ambasada e Britanisë në Shqipëri theksoi rëndësinë e ruajtjes së sundimit të ligjit dhe pavarësisë gjyqësore. “Ekzekutivi, gjyqësori dhe legjislativi mbeten partnerë të barabartë në mbështetjen e këtij progresi si pjesë e qëllimit të Shqipërisë për arritjen e anëtarësimit në BE. Ndërsa imuniteti parlamentar duhet të mbrojë proceset demokratike, ai nuk duhet të jetë pengesë për llogaridhënie të barabartë para ligjit”, thuhet mes tjerash në deklaratë. Shqipëria i ka hapur të gjithë kapitujt për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe synon të jetë pjesë e bllokut para vitit 2030.

INSTITUTI RIINVEST JEP REKOMANDIME PËR INTEGRIM MË TË SHPEJTË NË BE

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 12 MARS - Instituti Riinvest ka organizuar të enjten një tryezë për të ardhmen e Tregut të Përbashkët Rajonal, në të cilën dhënë edhe rekomandime për integrim më të shpejtë të Kosovës në Bashkimin Evropian. Alban Hashani, drejtor ekzekutiv i Institutit Riinvest, tha se Procesi i Berlinit ka krijuar një platformë bashkëpunimi mes vendeve të rajonit si dhe shteteve të BE-së. “Në një periudhë kur procesi i zgjerimit të BE-së po përballlet me sfida të llojllojshme, por edhe po nxit vështirësinë te vendet aspiruese, kjo iniciativë synonte që të mbante rajonin të ankoruar në perspektivën evropiane dhe të forconte bashkëpunimin. Procesi i Berlinit ka krijuar për rrjedhojë një platformë të rëndësishme bashkëpunimi midis vendeve të rajonit, shteteve anëtare të BE-së, institucioneve evropiane dhe rajonale, institucioneve financiare ndërkombëtare, sektorit privat dhe shoqërisë civile”, tha Hashani.

Ai përmendi fushat të cilat kanë qenë kyçe në Procesin e Berlinit. “Fokusi ka qenë në disa fusha kyçe si ndërlidhja infrastrukturore dhe energjetike, bashkëpunimi ekonomik, shoqëria civile dhe mobiliteti, si dhe një synim i integritit gradual të rajonit në tregun unik evropian. Pas më shumë se një dekade, pra që nga viti 2014, Procesi i Berlinit ka arritur disa suksese të rëndësishme, të cilat e kanë përmirësuar këtë bashkëpunim në rajon. Pra kanë qenë disa suksese të konkretizuara në disa fusha, veçanërisht në infrastrukturë, në ndërlidhje infrastrukturore por në fushën veçanërisht të telekomunikimit: roaming-u; mobiliteti, lëvizja e lirë me karta identiteti ndërmjet anëtarëve të Ballkanit Perëndimor; ‘green lanes’ apo shtigjet e gjelbra të lëvizjes së mallrave; njohja e diplomave, sistemi i pagesave, etj. Megjithatë, këto janë përballur me disa sfida, veçanërisht në fushën e mobilitetit, ku kemi ende moszbatim të marrëveshjeve, veçanërisht të njohjes së kartave të identitetit dhe targave të

Serbisë në raport me qytetarët e Kosovës”, tha Hashani. Visar Vokri, drejtor programor në Institutin Riinvest, tha se kanë organizuar takime të rregullta me shoqërinë civile për ide dhe rekomandime në vendimmarrje. “Gjatë këtyre dy viteve, kemi organizuar takime të rregullta konsultative, tryeza diskutimi me akterë të ndryshëm nga shoqëria civile, në mënyrë që t’i shkëmbejmë idetë edhe kështu së bashku t’i artikulojmë rekomandimet që janë të nevojshme për vendimmarrësit, me qëllim avancimin e bashkëpunimit dhe integritit të Ballkanit Perëndimor. Tregu i përbashkët rajonal, si një shtyllë e rëndësishme e integritit ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor, është instrument kyç për përshpejtimin e konvergencës në Bashkimin Evropian, duke lehtësuar lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Tregu i përbashkët rajonal synon të transformojë tregjet lokale të fragmentuara në një hapësirë ekonomike rajonale më të integruar, të aftë për të

tërhequr investime edhe për të rritur produktivitetin, edhe gjithsesi për të forcuar konkurrueshmërinë”, tha Vokri. Disa prej rekomandimeve që Vokri paraqiti janë prioritetizimi i marrëveshjeve të tregut rajonal për t’i forcuar kapacitetet institucionale dhe vullnetin politik. “Organizatat e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor njëzëri mendojnë se duhet të prioritetizohet zbatimi i marrëveshjeve të tregut rajonal, duke forcuar kapacitetet institucionale edhe vullnetin politik. Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të angazhojnë staf të kualifikuar dhe të krijojnë mekanizma të qartë mbikëqyrës për të siguruar që marrëveshjet e tregut të përbashkët rajonal përkthehen në integrim real dhe të preکشëm të tregut. Gjithashtu, duhet përshpejtuar harmonizimi i politikave dhe të eliminohen praktikat preferenciale dhe proteksioniste, të cilat veçse po e fragmentojnë edhe më shumë tregun”, tha ai, duke shtuar se qeveritë duhet të eliminojnë gradualisht gjithashtu praktikat

e njëanshme në prokurimin publik dhe kuotat që favorizojnë vetëm aktorët vendorë, dhe gjithashtu të standardizojnë rregullat e investimeve ndërkufitare. “Kjo qasje e unifikuar do të rrisë konkurrencën dhe do të mundësojë bizneset të operojnë lirshëm në gjithë rajonin. Suksesi i tregut të përbashkët rajonal varet nga fuqia e bizneseve vendorë”, shtoi Vokri. Jeton Zulfaj, koordinator për Procesin e Berlinit, Zyra e Kryeministrit, tha se ka pasur marrëveshje vitet e fundit rreth lëvizjes së lirë dhe çështjes së arsimit. “Prej atëherë ka pasur projekte konkrete. Pesë marrëveshje janë arritur. Tri prej tyre në nëntor të vitit 2022. Ajo për lëvizjen e lirë me ID, kartat e identitetit, për njohjen e profesioneve dhe për njohjen e institucioneve të arsimit të lartë. Pastaj në vitin 2023 dhe 2024 kemi arritur edhe dy marrëveshje tjera. Në vitin 2024 kemi shtuar profesionet dhe në 2023 e 2024 kemi edhe një marrëveshje për qasjen në studime. Kjo e fundit do t’i prejë shkollat e mesme”, tha Zulfaj.



Begaj: Shqipëria do të jetë zë i fortë në mbrojtje të shqiptarëve në Luginë

Tiranë, 12 mars - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka takuar kryetaren e komunës së Preshevës, Ardita Sinani, me të cilën kanë diskutuar për të drejtat e shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe për sfidat me të cilat përballen. “Shqipëria do të vijojë të jetë zë i fortë në mbrojtje të shqiptarëve në Preshevë,

Bujanoc dhe Medvegjë”, ka thënë Begaj pas këtij takimi. Sinani ka bërë me dije se Begajn e ka njoftuar për zhvillimet në Preshevë dhe për sfidat me të cilat përballen shqiptarët e Luginës. “Biseduam për projektet zhvillimore dhe për forcimin e bashkëpunimit me institucionet e Republikës së

Shqipërisë në fusha të rëndësishme për qytetarët tanë. Shpreha mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme të Shqipërisë në sensibilizimin e pozitës së shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe në afirmimin e të drejtave tona në çdo sferë të jetës si në arsim, kulturë dhe zhvillim ekonomik”, ka thënë Sinani.



ARSYET PRAPA PËRÇARJES OSMANI - KURTI

Ai që përshkruhej si “binom i shpresës” - bashkimi i forcave mes presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministrit të vendit, Albin Kurti - duket se u thyë kur askush nuk e priste. Për më tepër, as arsyet nuk janë të vogla, meqë afërsia e presidentes me Shtetet e Bashkuara duket se është ndër kryesoret. Çfarë ndodhi mes udhëheqësve dhe sa e dëmton kjo Kosovën?

PRISHTINË, 12 MARS - Shprehja e famshme se “diçka ndodhi dhe pjesa tjetër është histori” nuk vlen për zhvillimet e ditëve të fundit në Kosovë. Ndonëse prej javësh përflitej se presidentja Vjosa Osmani nuk e gëzonte mbështetjen e kryeministrit Albin Kurti për një mandat të dytë, në publik diçka e tillë nuk reflektohej nga ata dy. Të paktën jo derisa partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje (LV), paraqiti dy kandidatë të tjerë për president, më 5 mars, dhe Osmani doli të nesërmen me dekret për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës.

Presidenti i ri nuk u zgjodh për shkak të mungesës së kuorumit, ndërsa LV-ja tha se dekreti i Osmanit është jokushtetues, dhe e çoi lëndën në Gjykatën Kushtetuese. Si rrjedhojë, u paralizua edhe dekreti, edhe puna e Kuvendit deri më 31 mars.

Ndërkohë, interesimi i publikut sa shkon e rritet për gjithë atë çfarë ndodhi dhe mund të ndodhë.

Pse u përçanë Osmani dhe Kurti? Të gjitha hollësitë mund të mos dalin kurrë në shesh, por disa sinjale janë të lexueshme.

Presidentja Osmani tha në një intervistë për Syri TV, të hënën, se rritja e partneritetit mes Kosovës dhe administratës aktuale amerikane do të duhej të shihej si sukses, dhe jo pengesë.

Kosova e sheh ShBA-në si aleaten kryesore, dhe mbështetja e saj ishte jetike si në shpalljen e pavarësisë, ashtu edhe në formimin e institucioneve. Megjithatë, s’është sekret që Kurti i ka tensionuar disa herë marrëdhëniet me autoritetet amerikane.

Radio Evropa e Lirë kërkoi një koment nga Qeveria e Kosovës nëse marrëdhëniet e afërta të Osmanit me ShBA-në mund t’i kenë penguar Kurtin, dhe se çfarë saktësisht ka ndodhur mes tyre, por nuk mori përgjigje.

Njohësi i zhvillimeve politike, Agon Maliqi, thotë për Radion Evropa e Lirë (REL) se Osmani mund të mos i ketë thënë të gjitha, për faktin se është ende në detyrë, por konsideron se ajo ia ka borxh opinionit publik një shpjegim për këtë deklaratë. “Historikisht, [Shtetet e Bashkuara] e kanë



pasur të vështirë të ndërtojnë raport bashkëpunues me kryeministrin Kurti, raport produktiv, të ndërtuar në besim. Gjithsesi ka pasur bashkëpunim në disa sfera të caktuara me Qeverinë, në mbrojtje, në siguri, në ekonomi, por besoj që ekziston një lloj dyshimi në mundësinë për të ndërtuar partneritet produktiv”.

Marrëdhëniet ShBA - Kurti

Përgjatë mandatit të dytë të Kurtit, autoritetet amerikane

thanë disa herë publikisht se Kosova nuk e trajtoi ShBA-në si partnere, dhe që vendime të caktuara të Qeverisë ndikuan në cilësinë e marrëdhënieve mes dy vendeve.

ShBA-ja e pezulloi edhe Dialogun Strategjik me Kosovën, ende pa nisur ai. Vendimi u komentua gjerësisht si sinjal i distancimit nga Kurti. Vetë kryeministri tha me raste se nuk ishte prishur me Amerikën, por se kishte dallime me të në disa çështje.

Presidentja Osmani, në anën tjetër, ftohej dhe takohej me figura të rëndësishme të

administratës amerikane në Uashington, dhe sa herë situata tensionohej, ajo e përsëriste rëndësinë e ruajtjes së raporteve me aleatin kyç.

Maliqi sheh potencial që në të ardhmen deklaratat e fundit të Osmanit të bëhen problematike në raportet me ShBA-në. “Nëse ata [amerikanët] nuk e gjejnë dikë në institucionet e Kosovës, qoftë në Qeveri, qoftë në Presidencë, që e shohin si partner të besueshëm, atëherë kjo marrëdhënie nuk mund të prodhojë aq shumë sa mundet”. Edhe Visar Ymeri, drejtues i Institutit “Musine Kokalari”,

përmendi ditë më parë për REL-in se janë pikërisht marrëdhëniet e Osmanit me ShBA-në që në sytë e Kurtit shihen si mungesë besnikërie të cilën ai e kërkon.

Osmani tregoi përgjatë intervistës së 9 marsit se nuk ka pasur fare komunikim dhe koordinim me Kurtin kur ajo ishte nisur drejt Davosit të Zvicrës, më 22 janar, për ta përfaqësuar vendin në themelimin e Bordit të Paqes - nismë e presidentit amerikan, Donald Trump, për t’iu dhënë fund konflikteve nëpër botë.

Sipas saj, ndonëse Kurti ishte atje, autoritetet amerikane i kërkuan asaj që merrte pjesë në ceremoninë e themelimit, dhe me gjithë përpjekjet, stafi i presidentes nuk arriti të bisedonte paraprakisht me atë të kryeministrit.

Si do të ndikojë përçarja në skenën politike?

Maliqi beson se ekziston “efekti Osmani” te rritja e përqindjes së votave për LV-në viteve të fundit. Sipas tij, edhe vetë Osmani duket se e sheh Kurtin si “borxhli” në këtë drejtim, prandaj beson se mund t’ia marrë mbrapsht kapitalin politik dhe ta çojë diku tjetër. “Një efekt do ta ketë, nuk e lë pa shenjë kjo LV-në, sepse më 2021, fryma që u prodhuan, mitologjia që u prodhuan e fitores, ishte e përbashkët, dhe ishte Osmani ajo që në njëfarë forme e shembi Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe e çoi votuesin e LDK-së [te LV-ja]”.

Më 2021 Kurti dhe Osmani, duke garuar në një listë të përbashkët, fituan mbi 50 përqind të votave në zgjedhjet parlamentare dhe siguruan rezultatin më të mirë ndonjëherë për një subjekt politik prej pavarësisë së Kosovës.

Më 28 dhjetor 2025 LV-ja arriti rezultat edhe më të mirë, por Maliqi beson se Osmani pati sërish dorë, sepse “ajo e pranoi edhe publikisht që kishte përdorur Presidencën për t’ia ndihmuar Kurtin qeverisjen dhe fitoren në zgjedhjet e fundit”. Sipas Maliqit, zgjedhjet e parakohshme janë të pashmangshme sivjet - dhe dilema e vetme është rreth datës kur do të mbahen ato.

ÇFARË PARASHIHET NË STRATEGJINË E MIRATUAR PËR ZGJERIMIN E BE-SË? PËR KOSOVËN PËRMENDET RËNDËSIA E DIALOGUT

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2022, mirëpo aplikimi i saj nuk është shqyrtuar ende. Kështu, ajo është e vetmja në Ballkanin Perëndimor që nuk e gëzon statusin e vendit kandidat. Kur përmendet Kosova në raport, aty theksohet rëndësia e dialogut të saj me Serbinë për avancim në rrugën drejt anëtarësimit

PRISHTINË, 12 MARS - Deputetët e Parlamentit Evropian e kanë miratuar një strategji për zgjerim të Bashkimit Evropian në të cilën thuhet se zgjerimi është përgjigje strategjike ndaj realiteteve gjeopolitike që po ndryshojnë dhe investim në sigurinë dhe stabilitetin e bllokut evropian.

Sipas dokumentit të miratuar më 11 mars, kostoja e moszgjerimit do ta tejkalonte koston e anëtarësimit të vendeve të reja në BE, dhe do të rrezikonte krijimin e zonave gri gjeopolitike të ndjeshme ndaj ndikimit të huaj antagonist. Për strategjinë votuan 385 deputetë, 147 ishin kundër dhe 98 abstenuan, raporton REL.

Autori i dokumentit, eurodeputeti Petras Austrevicius, tha se marrë parasysh sfidat e sotme, modeli i integritetit të BE-së duhet të përmirësohet në mënyrë që të pasqyrojë më mirë interesat e BE-së dhe pritjet nga vendet kandidatë. “Zgjerimi i BE-së

duhet të shkojë krah për krah me reformat e brendshme për të mbrojtur funksionimin e BE-së dhe për t'i përmirësuar proceset e vendimmarrjes, duke përfshirë shfrytëzimin më të madh të votimit me shumicë të kualifikuar. BE-ja duhet t'i përfundojë këto reforma deri në kohën kur vendet kandidatë t'i plotësojnë kriteret e anëtarësimit dhe janë gati të bashkohen me BE-në”, tha eurodeputeti Austrevicius. Sipas dokumentit të miratuar, Shqipëria dhe Mali i Zi kanë vendosur tashmë objektiva ambicioze për përfundimin e negociatave të anëtarësimit deri më 2026-2027.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2022, mirëpo aplikimi i saj nuk është shqyrtuar ende. Kështu, ajo është e vetmja në Ballkanin Perëndimor që nuk e gëzon statusin e vendit kandidat. Kur përmendet Kosova në raport, aty theksohet rëndësia e dialogut të



saj me Serbinë për avancim në rrugën drejt anëtarësimit. Mes të tjerash në raport bëhet thirrje që të nisin negociatat e anëtarësimit me Ukrainën dhe Moldavinë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe që asnjë vend të mos trajtohet si pjesë e një pakete. “Sundimi i ligjit, reformat demokratike, liria e medias, të drejtat e pakicave, pavarësia e gjyqësorit dhe lufta kundër korrupsionit duhet të mbeten në krye të prioritetëve të procesit të zgjerimit, me mbështetje të qëndrueshme për shoqërinë civile”, thuhet në dokument.

Ai, gjithashtu, nënvizon domosdoshmërinë e përafrimit me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, e cila vlerësohet si “një tregues kyç i orientimit gjeostrategjik të vendit kandidat”. Në këtë drejtim, Serbia është kritikuar shpesh për mospërputhje të politikës së jashtme me atë të bllokut, megjë është vendi i vetëm në Ballkan që nuk e ka sanksionuar Rusinë për nisjen e luftës në Ukrainë. Para votimit të këtij raporti, në Parlamentin Evropian është zhvilluar një debat, në të cilin mori pjesë edhe komisionarja

për Zgjerim e BE-së, Marta Kos, e cila tha se BE-ja nuk do të lejojë anëtarësimin e vendeve që mund t'i minojnë fshehurazi vlerat ose institucionet e BE-së. “Nuk ka kuaj të Trojës. Vendet që do të na minonin nga brenda nuk mund të bëhen anëtarë të BE-së. Duhet të jemi absolutisht të sigurt për këtë. Vendet që i bashkohen BE-së duhet të jenë demokraci të forta dhe të afta t'i rezistojnë ndikimit toksik të Rusisë dhe të të tjerëve”, tha mes tjerash Kos.

Bashkimi Evropian është zgjeruar herën e fundit më 2013, me pranimin e Kroacisë.

KQZ-ja PEZULLON AKR-në

PRISHTINË, 12 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) përmes një vendimi e ka pezulluar partinë Aleanca Kosova e Re (AKR), e themeluar nga Behgjet Pacolli. Shkaku që ka çuar në pezullimin e kësaj partie është dështimi për t'i organizuar zgjedhjet e brendshme brenda afatit.

Drejtori i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, Besnik Buzhala, tha se Aleanca Kosova e Re, e regjistruar në KQZ në vitin 2007, ka qenë e obliguar që deri më 25 shkurt 2026 ta mbajë Kuvendin Zgjedhor.

Buzhala shtoi se më 4 dhe 24 shkurt 2026, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) e ka njoftuar këtë subjekt politik për obligimin ligjor por, pavarësisht prej këtyre njoftimeve, nuk janë ndërmarrë veprime për përbushjen e këtij obligimi. “Andaj, duke u mbështetur në këtë, KQZ-ja mori vendim për pezullimin e partisë politike Aleanca Kosova e Re dhe ta obligojë atë, që në një afat

shtesë prej 45 ditësh, ta mbajë kuvendin e saj. Në rast të mosmbajtjes së kuvendit zgjedhor as pas këtij afati shtesë, KQZ-ja do ta çregjistrojë këtë parti politike nga regjistri i partive politike në Kosovë”, tha ai. Pas rreth dy dekadash në krye të Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli kishte dhënë dorëheqje nga kjo parti në tetor 2025, raporton “Kallxo”. Ushtrues detyre i kryetarit të Aleancës Kosova e Re është Vesel Makolli.

AKR-ja në zgjedhjet e mbajtura më 09.02.2025 ka marrë pjesë në garën zgjedhore si pjesë e koalicionit ‘Lista për Familjen’, megjithatë, për herë të parë, Behgjet Pacolli nuk ka qenë pjesë e listës për deputet.

Koalicioni, në fakt, nuk arriti ta kalojë pragun zgjedhor për të qenë pjesë e Kuvendit. Behgjet Pacolli dhe AKR-ja për herë të parë u bënë pjesë e Kuvendit të Kosovës në vitin 2007. Vet Pacolli i cili në vitin 2011 u zgjodh presidenti i tretë i Republikës së Kosovës, ka qenë deputet për pesë mandate.



Ka qenë zëvendëskryeministër i parë i Kosovës në periudhën 2011-2014, pasi paraprakisht kishte dorëheqje nga posti i presidentit, për shkak të një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, i cili e nxori vendimin e Kuvendit të datës 22 shkurt 2011, lidhur me zgjedhjen

e tij president, si jo jokushtetues. Në periudhën 2017-2020 ka qenë ministër i Punëve të Jashtme. Makolli, në anën tjetër, deri në momentin e marrjes së detyrës si u. d. i kryetarit të partisë, ishte sekretar i AKR-së. Me statut të partisë, AKR-ja, është parti politike me orientim liberal-

demokratik të qendrës. Emërtimi i partisë politike, Aleanca Kosova e Re, rrodhi nga organizata për lobim “The Alliance for New Kosova” që u themelua dhe u organizua nga Behgjet Pacolli në Uashington në vitet 2004-2006, për të lobuar për pavarësinë e Kosovës.

MOSKUPTIMI I KOMPROMISIT SI THEMEL I KRIZËS INSTITUCIONALE NË KOSOVË



Shkruan: Arben GASHI

Kriza e përsëritur institucionale në Kosovë shpesh interpretohet si krizë politike apo kushtetuese. Megjithatë, në thelb ajo është shumë më e thellë: është krizë e moskuptimit të natyrës së shtetit të Kosovës. Ideja mbi të cilën është ndërtuar shteti i Kosovës nuk është ide e dominimit politik, por ide e kompromisit. Mospranimi ose mosinternalizimi i kësaj logjike ka prodhuar tensione të vazhdueshme në funksionimin e institucioneve dhe në praktikën politike.

Shteti i Kosovës si produkt kompromisi

Paradoksi themelor i shtetësisë së Kosovës është se edhe vetë liria e saj është rezultat i një kompromisi historik dhe politik. Në mesin e viteve '90, Ibrahim Rugova artikuloi një ide që në shikim të parë mund të dukej paradoksale: pavarësia e Kosovës është kompromisi i shqiptarëve për liri, pra heqja dorë nga projekti i bashkimit kombëtar në favor të një shteti të pavarur në kufijtë ekzistues. Mbi këtë logjikë kompromisi u ndërtuan disa nga proceset më vendimtare të historisë moderne të

Kosovës: rezistenca politike e viteve '90, ndërhyrja ndërkombëtare e vitit 1999 dhe më pas procesi i shtetndërtimit. Në këtë kuptim, kompromisi nuk është dobësi e projektit shtetëror të Kosovës, por themeli i tij politik dhe ndërkombëtar.

Kushtetuta: kompromisi i institucionalizuar

Ky karakter i kompromisit është përkthyer drejtpërdrejt edhe në arkitekturën kushtetuese të shtetit. Kushtetuta e Kosovës është ndër dokumentet më gjithëpërfshirëse në Evropë sa i përket mbrojtjes së komuniteteve joshumicë dhe balancave institucionale. Elemente të tilla si:

- vendet e rezervuara për komunitetet joshumicë në Kuvend,
 - mekanizmi i shumicës së dyfishtë për ndryshimet kushtetuese,
 - mbrojtja e zgjeruar e të drejtave kolektive,
- janë manifestim i qartë i një kompromisi të institucionalizuar. Këto dispozita nuk janë aksidentale, por janë projektuar për të detyruar politikën kosovare të funksionojë mbi bazën e konsensusit dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve politikë dhe komuniteteve.

Krizat institucionale si krizë e kulturës së kompromisit

Kriza e fundit rreth zgjedhjes së Presidentit të Kosovës është

ilustrim i kësaj problematike. Kushtetuta është e qartë për procedurën: në dy raundet e para kërkohet një shumicë prej dy të tretash e deputetëve. Ky mekanizëm nuk është thjesht rregull teknik; ai është një imponim kushtetues i kompromisit politik. Megjithatë, në praktikë politika kosovare shpesh e interpreton këtë rregull si pengesë taktike, jo si kërkesë për marrëveshje politike. Për këtë arsye krizat nuk burojnë nga paqartësia kushtetuese apo nga ndonjë konflikt ideologjik, por nga pamundësia për të ndërtuar kompromis politik.

Tre faktorë që kanë penguar kulturën e kompromisit

Nëse analizohet zhvillimi politik i Kosovës në dy dekadat e fundit, mund të identifikohen disa faktorë që kanë penguar krijimin e një kulture funksionale kompromisi.

1. Trashëgimia e protektoratit ndërkombëtar

Gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar, krizat politike shpesh zgjidheshin nga aktorët ndërkombëtarë. Kjo krijoi një kulturë politike ku përgjegjësia për kompromis delegohej jashtë sistemit politik vendor. Edhe pas pavarësisë, kjo logjikë vazhdoi të funksionojë në mënyrë indirekte përmes një forme tjetër: "protektoratit kushtetues", ku Gjykata Kushtetuese pritet të zgjidhë çështje që në fakt janë probleme politike dhe kërkojnë

marrëveshje.

2. Narrativi i dominimit politik

Në shumë cikle zgjedhore në Kosovë është ndërtuar narrativa e "fitores totale" dhe e dominimit politik. Partitë kanë konkurruar duke premtuar se do të qeverisin të vetme dhe do të imponojnë vullnetin e tyre politik. Në një sistem të ndërtuar mbi kompromis, ky narrativ është në vetvete kontradiktor. Në këtë kontekst, një nga humbjet më të mëdha politike ka qenë edhe pozicioni i LDK-së, e cila historikisht ka përfaqësuar një kulturë politike më konsensuale. Në një klimë populiste ku dominimi shihet si virtyt politik, diskursi i kompromisit shpesh është perceptuar si dobësi dhe jo si përgjegjësi shtetformuese.

3. Mungesa e debatit për idenë e shtetit

Diskursi politik në Kosovë shpesh dominohet nga çështje të përditshme dhe konflikte taktike. Ka munguar një debat i thellë publik për: • modelin e shtetit, • organizimin e shoqërisë, • orientimin afatgjatë të zhvillimit politik dhe institucional. Pa këtë debat strategjik, kompromisi reduktohet në negociatë momentale politike dhe jo në parim të përhershëm institucional.

Dy rrugë përpara

Në këtë kontekst, Kosova përballet me dy alternativa strategjike. Alternativa e parë është ndërtimi i

një kulture të qëndrueshme kompromisi politik. Kjo do të nënkuptonte që për çështje themelore si konstituimi i institucioneve, zgjedhja e Presidentit apo reformat kushtetuese të krijohet një standard i qëndrueshëm bashkëpunimi ndërpartiak. Një kulturë e tillë do të ishte në përputhje të plotë me filozofinë kushtetuese të shtetit. Alternativa e dytë do të ishte ndryshimi i sistemit politik drejt një sistemi mazhoritar, ku fituesi merr pothuajse gjithë pushtetin. Megjithatë, për një shtet të vogël, me pluralizëm të ndjeshëm etnik dhe me traditë relativisht të re institucionale, një sistem i tillë mbart rrezikun e krijimit të një dominimi autoritar dhe të tensioneve të brendshme politike e sociale.

Përfundim

Kriza institucionale në Kosovë nuk është thjesht krizë e institucioneve; ajo është krizë e kuptimit të projektit shtetëror. Kosova është ndërtuar mbi kompromis historik, ndërkombëtar dhe kushtetues. Sa më shumë politika kosovare të përpqet ta zëvendësojë këtë logjikë me logjikën e dominimit, aq më shumë sistemi do të prodhojë bllokada dhe kriza.

Prandaj sfida kryesore e politikës kosovare nuk është vetëm fitimi i zgjedhjeve, por internalizimi i kompromisit si kulturë politike dhe standard shtetformues. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet stabilitet institucional dhe funksionim i qëndrueshëm i demokracisë në Kosovë.

AGK-ja E DËNON GJUHËN E PAPRANUESHME DHE TË RREZIKSHME TË ABDIXHIKUT KUNDËR MEDIEVE DHE GAZETARËVE

PRISHTINË, 12 MARS - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) e dënon ashpër gjuhën e përsëritur akuzuese të kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku, kundër medieve dhe gazetarëve në Kosovë. Abdixhiku në një intervistë televizive të mërkurën ka folur prapë për "mercenarë mediaë" duke thënë se "shumë lehtë japin një shpifje, papërgjegjësi, vetëm se u rritet atje llogaria bankare prej sponsorizuesve, kundërshtarëve të ndryshëm". "Këto pretendime të zotit Abdixhiku janë një sulm frontal kundër medias, lirisë së medias dhe shprehjes në Kosovë. Një gjuhë e tillë me kualifikime si 'mercenarë' është e papërgjegjshme, e papranueshme, shumë e rrezikshme dhe mund të paraqesë problem edhe në

cenimin e sigurisë fizike të gazetarëve. Është poqasërisht për keqardhje që këto deklarata të zotit Abdixhiku vijnë në kohën që ai është në opozitë, dhe me përkrahje prej 13 %. AGK-ja e fton z. Abdixhiku të heqë dorë nga këto spekulime dhe nëse ka fakte t'i denoncojë ato në organet përgjegjëse. AGK-ja gjithashtu e fton zotit Abdixhiku që bashkë me 14 deputetët e tjerë të partisë së tij në Kuvend, LDK të kontribuojë për një ambient të lirë medial", thuhet në reagimin e AGK-së. Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës ka shprehur shqetësimin për reagimin e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, i cili, sipas LDK-së, në vend se ta trajtojë me seriozitet shqetësimin e ngritur për standardin profesional dhe përgjegjësinë publike në medie,



zgjedh të përdorë etiketime politike dhe të delegjitimojë një qëndrim të shprehur publikisht. "Në një shoqëri demokratike, kritika dhe debati publik janë pjesë e pandashme e lirisë së shprehjes. Liria e medias dhe liria e shprehjes nuk përjashtojnë njëra-tjetrën; përkundrazi, ato bashkëjetojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën. Është e papritur që një organizatë profesionale si AGK të përdorë gjuhë dhe referenca që i përkasin debatit politik, përfshirë edhe përqindjet elektorale. AGK nuk është subjekt politik dhe nuk i takon të bëjë vlerësime të tilla", theksohet në reagimin e LDK-së, duke shtuar se mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e lirisë së medias dhe të lirisë së shprehjes, njëkohësisht duke kundërshtuar shpifjet dhe dezinformatat.

Çfarë po paralajmëron Abdixhiku: “Koha kërkon bashkim”?

PRISHTINË, 12 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se tani është koha që kërkon bashkimin. Ai ua ka përcjellë këtë mesazh institucionalistëve, mbështetësve të Republikës dhe të gjithë udhëtarëve të rrugës euroatlantike, duke theksuar se të gjithë këta kanë një shtëpi të përbashkët, Lidhjen

Demokratike të Kosovës. “Prandaj, do të nis bashkimin e madh politik e qytetar rreth një projekti të përbashkët. Një projekti që tejkalon secilin prej nesh. Që tejkalon dallimet e vogla, ambiciet e mëdha dhe hidhërimet e së shkuarës. Ato në kohë krizash e përballë fateve të mëdha të së ardhmes, bëhen krejtësisht të parëndësishme. Dramat e

sotme, krizat e përvitshme dhe fajësimet e pandalshme po e shterojnë Kosovën. Vendit i duhet një tjetër rrëfim. Një rrëfim që bashkon, që normalizon jetën politike, që zhvillon shtetin dhe e ankoron përgjithmonë në Perëndim. Le ta bëjmë. Do ta bëjmë!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Pas përplasjeve Kurti - Osmani

është përfolur mundësia e rikthimit në LDK e Vjosa Osmanit. Zyrtarë të kësaj partie, po ashtu edhe lideri i saj, Lumir Abdixhiku, nuk kanë përjashtuar mundësinë që Osmani të rikthehet në LDK. Tashme pritet të qartësohet çdo gjë rreth së ardhmes politike të Vjosa Osmanit pas vendimit që do ta marrë më 31



13 mars Gjykata Kushtetuese, nëse vendo di të shkojë në zgjedhje të parakohshme.

NË 45-VJETORIN E PROTESTAVE STUDENTORE TË '81-s, KURTI VIZITON VEPRIMTARIN MEHMET HAJRIZI

PRISHTINË, 12 MARS - Në përvjetorin e 45-të të protestave studentore të vitit 1981, kryeministri Albin Kurti ishte për vizitë te veprimtari i çështjes kombëtare, Mehmet Hajrizi. Kurti ka thënë se baca Mehmet nuk është thjesht veprimtar që e përkufizon aktiviteti i tij politik. “Ai vjen edhe nga një familje e përfshirë në aktivizëm politik dhe përndjekje nga regjimi serb që nga vitet e '20-ta të shekullit të kaluar. Për 15 vjet ai punoi në arsim, duke edukuar breza të tërë nxënësish. Një nga momentet më të rënda të jetës së tij ishte arrestimi në sallën e mësimit, para nxënësve të tij.



Ky ishte arrestimi i tij i dytë, pasi për herë të parë ishte arrestuar në vitin 1979”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Ai ka theksuar se në fillim të

viteve '70 u formua organizata ilegale “Grupi Revolucionar i Kosovës”, një ndër organizatat më serioze dhe më jetëgjata të lëvizjes së asaj kohe.

“Fillimisht ajo u udhëhoq për një vit nga Kadri Osmani, ndërsa për tetë vjet të tjerë nga Mehmet Hajrizi. Më vonë ai, së bashku me shokët e tij, u bë pjesë e themelimit të shtypit të parë klandestin, ku shërbeu edhe si kryeredaktor. ‘Zëri i Kosovës’, ‘Pararoja’, ‘Liria’, ‘Këngët e lirisë’ dhe shumë trakte të tjera politike që ngjallën vrull patriotik dhe përhapën frymën e rezistencës gjithandej vendit, me kërkesa për liri, drejtësi, Republikë dhe bashkim kombëtar”, ka theksuar Kurti, duke shtuar se Mehmet Hajrizi u arrestua më 18 dhjetor 1981, ndërsa më 10 korrik 1982, bashkë me një grup

veprimtarësh, u dënua me 12 vjet burg të rëndë. “Në atë kohë udhëheqjen e organizatës e mori Kadri Zeka, i cili u vra një vit më vonë së bashku me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën. Lufta çlirimtare e fundit në Kosovë ishte pa dyshim produkt i shumë brezave që ndër vite u angazhuan për liri dhe avancimin e çështjes kombëtare. Ndërkaq, ngjarjet e mëdha janë rezultat i një pune të përditshme paraprake që këto organizime kanë bërë së bashku me popullin e Kosovës. Mirënjohje për të gjithë ata që u përpoqën e kontribuan për liri e bashkim”, ka shkruar Kurti.

NË QKUK KRYHET PËR HERË TË PARË NDËRHYRJA MODERNE PËR TRAJTIMIN E GURËVE TË MËDHENJ NË VESHKA



Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka shënuar një avancim të rëndësishëm në fushën e urologjisë, duke realizuar për herë të parë në Kosovë intervenimin kirurgjik minimal invaziv Nephrolitotomia Perkutane (PCNL - Percutaneous Nephrolithotomy) për trajtimin e gurëve të mëdhenj në veshka. Deri më tani pacientët me këtë patologji kanë qenë të detyruar të kërkojnë trajtim jashtë

institucioneve publike shëndetësore. Fillimi i aplikimit të kësaj procedure në QKUK përbën një hap të rëndësishëm në avancimin e shërbimeve urologjike dhe në ofrimin e trajtimeve moderne brenda sistemit publik shëndetësor në Kosovë. Procedura është realizuar nga ekipi i Klinikës së Urologjisë në bashkëpunim me Klinikën e Anesteziologjisë, duke përdorur teknologjinë bashkëkohore të laser-it holmium, e cila mundëson thyerjen dhe largimin e gurëve në veshka përmes një



qasjeje minimale invazive. Metoda PCNL përdoret për trajtimin e gurëve të mëdhenj në veshka dhe realizohet përmes një prerjeje shumë të vogël në lëkurë, duke mundësuar qasje direkte në veshkë. Kjo teknikë redukton traumën kirurgjike, kohën e qëndrimit në spital dhe periudhën e rikuperimit të pacientit. Pacienti me inicialet N. M., i lindur në vitin 1967, është rasti i parë që iu nënshtrua me sukses këtij intervenimi dhe është liruar për në shtëpi në gjendje të mirë shëndetësore.

Gërvalla thotë se do të ketë rend, siguri dhe integritet në të gjitha institucionet korrektuese

PRISHTINË, 12 MARS - Ministria e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka njoftuar se në Lipjan ka takuar drejtorët e institucioneve korrektuese dhe drejtorët e departamenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilët ka trajtuar drejtpërdrejt çështjet që lidhen me sigurinë, menaxhimin dhe integritetin e sistemit korrektues. “Siguria në institucionet korrektuese, parandalimi i kontrabandës,

forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe zbatimi i plotë i ligjit janë përgjegjësi që nuk lënë hapësirë për kompromis. Institucionet korrektuese kërkojnë disiplinë, profesion-alizëm dhe standarde të qarta të llogaridhënies në çdo nivel të drejtimit. Çdo institucion duhet të funksionojë me rend të plotë, me kontroll efektiv dhe me përgjegjësi të qartë institucionale, sepse çdo dobësi në këtë sistem dëmton drejtpërdrejt besimin e qytetarëve në drejtësi”, ka thënë Gërvalla.

Ajo ka theksuar se sistemi korrektues duhet të jetë i fortë, i disiplinuar dhe i drejtë. “Kjo kërkon udhëheqje të vendosur, zbatim të pakompromis të ligjit dhe përkushtim të plotë institucional për të garantuar sigurinë, rendin dhe integritetin e çdo institucioni korrektues në vend. Këto standarde nuk janë vetëm prirje institucionale, por përgjegjësi që do të ndiqen me seriozitet dhe vëmendje të vazhdueshme nga afër”, është shprehur ajo.



Ministri Hoti premtan mbështetje për punëtorët privatë dhe sindikatat

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka pritur në takim njoftues kryetarin e Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemin, me të cilin ka biseduar për rëndësinë e ndërtimit të komunikimit dhe bashkëpunimit, në të mirë të punëtorëve në sektorin privat. Ministri Hoti theksoi se në mesin e 9 projektligjeve në planin

legjislativ për vitin 2026, janë disa ligje të cilat avancojnë dhe forcojnë mburojën ligjore për punonjësit e sektorit privat, ndërkaq theksoi se të gjithë mekanizmat e Ministrisë do të fuqizohen dhe do të jenë shumë aktivë. Kryetari i SPSPK-së, Jusuf Azemi, e uroi ministrin Hoti për detyrën, duke shprehur gatishmëri të plotë për bashkëpunim të singertë dhe të hapur, ndërsa

përcolli informacione për sfidat me të cilat përballlet sektori privat. Në takimin që u përmbyllë në frymën e bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë, ministri Hoti theksoi se do të jetë i përkushtuar që të ketë rifreskim dhe zbatim strikt të ligjeve aktuale, ndërsa u zotua se shumë punë të mira do të realizohen gjatë këtij mandati, duke i balancuar kërkesat me

mundësitë. Ndërkaq kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, theksoi se problem kryesor momental mbetet moszbatimi i pagës minimale. Ai shtoi se sektori privat përballlet me sfida të shumta, duke përfshirë: Mungesën e Marrëveshjes Kolektive; Mosformimin e Gjykatës së Punës; Nevojën për më shumë veprime mbi



rrezikshmërinë e punëtorëve në vendin e punës; Mungesën e një fondi për rastet e vdekjeve në vendin e punës dhe Formimin e Këshillit Ekonomiko-Social. “Jemi pajtuar që këto procese t’i shtyjme bashkërisht përpara”, tha Azemi.

INSPEKTORATI VAZHDON MBIKËQYRJEN E TREGUT TË DERIVATEVE TË NAFTËS

PRISHTINË, 12 MARS - Inspektorati Qendror i Mbiqëqyrjes së Tregut pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit ka njoftuar se, në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të tregut të derivateve të naftës, është duke realizuar mbikëqyrje intensive lidhur me zbatimin e vendimit për rregullimin e përkohshëm të çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse të nënshkruara nga ministrja Mimoza Kusari-Lila më 4 mars, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit, rritjen e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme si dhe mënjanimin e çrregullimeve në treg. Gjithashtu, Inspektorati Qendror



i Mbiqëqyrjes së Tregut, së bashku me Administratën Tatimore të Kosovës është duke realizuar analiza të të dhënave lidhur me çmimet e importit dhe çmimet e ekspozuara për konsumatorët në tregun vendor.

“Sipas të dhënave zyrtare të siguruara nga evidencat e Doganës së Kosovës, çmimi mesatar i importit për derivatet e naftës gjatë ditës së mërkurë, datë: 11.03.2026, ka qenë si në vijim: Naftë (dizel): 1.40

euro/litër. Benzinë: 1.22 euro/litër. Ndërkohë, bazuar në monitorimin e realizuar në tregun vendor, çmimet e ekspozuara për konsumatorët në pikat e shitjes me pakicë rezultojnë si më poshtë: Naftë (dizel): nga 1.44 euro/litër deri në 1.54 euro/litër. Benzinë: nga 1.18 euro/litër deri në 1.31 euro/litër. Bazuar në vendimin e datës 04.03.2026 për rregullimin e përkohshëm të çmimeve dhe caktimit të masave të tjera mbrojtëse është vendosur marzha tregtare maksimale e lejuar si vijon: dy eurocentë për litër të produktit të shitur me shumicë, dhe dymbëdhjetë euro centë për litër të produktit të shitur me pakicë. Marzhë

tregtare domethënë ndryshimi mes çmimit të shitjes dhe çmimit të furnizimit”, ka njoftuar Inspektorati Qendror i Mbiqëqyrjes së Tregut. Ky institucion ka njoftuar se do të vazhdojë të monitorojë dhe inspektojë në mënyrë intensive zhvillimet në tregun e derivateve të naftës së bashku me Doganën e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës si dhe Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës dhe, në të gjitha rastet ku identifikohen parregullsi eventuale, mosrespektim i vendimit të marzhës apo praktikave që mund ta dëmtojnë konkurrencën dhe konsumatorët, do të ndërmerren masa rigorozë të parapara me legjislacionin në fuqi.

MINISTRJA KUSARI-LILA TAKOI DREJTUES TË AGJENCIVE SHETETËRORE, DISKUTOHET PËR LEHTËSIMIN E TË BËRIT BIZNES

PRISHTINË, 12 MARS - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit ka zhvilluar takime pune të ndara me drejtues të agjencive shtetërore: të Administratës Tatimore dhe të Doganës së Kosovës, me të cilët ka diskutuar për çështje që lidhen me lehtësimin e të bërit biznes dhe përmirësimin e shërbimeve për ndërmarrjet dhe qytetarët. Ministrja Kusari-Lila theksoi se me drejtorin e përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni, kanë

biseduar për unifikimin dhe azhurnimin e të dhënave të bizneseve në bashkëpunim me ARBK-në, në mënyrë që informacionet për bizneset të jenë sa më të sakta dhe të përditësuara. Po ashtu, është diskutuar për uljen e burokracisë në raport me shërbimet që institucionet ua ofrojnë bizneseve si dhe për zhvillimin dhe avancimin e sistemit informues të ARBK-së. Ndërkaq me drejtorin e përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Agron Llughaliu, ministrja ka theksuar se kanë biseduar për



mundësitë e krijimit të lehtësirave shtesë për bizneset, eliminimin e disa tarifave dhe shkurtimeve të burokracive në vendkalimet

kufitare me vendet e rajonit. Sipas saj, është diskutuar edhe për bashkëpunimin institucional në kontrollin e cilësisë së derivateve

si në tregun e jashtëm po ashtu edhe në atë të brendshëm. Ajo ka vlerësuar se bashkëpunimi ndërinstitucional dhe përmirësimi i shërbimeve për bizneset mbeten thelbësore për një ekonomi më funksionale dhe më konkurruese. Gjatë takimit ministrja ka potencuar se mbështetja e ndërmarrjeve dhe krijimi i kushteve më të mira për biznesin janë hapa të domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe më shumë mundësi për qytetarët tanë.

Autorizohet pagesa e subvencioneve të mbetura bujqësore për vitin 2025

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, ka nënshkruar vendimin për autorizimin e pagesës së detyrimeve të mbetura nga Programi i Pagesave Direkte për vitin 2025. Me këtë vendim, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) obligohet të procedojë menjëherë

ekzekutimin e pagesave për të gjithë përfituesit e verifikuar të subvencioneve bujqësore sipas listave përfundimtare të miratuara në kuadër të Programit për Pagesa Direkte për vitin 2025. Pagesat do të realizohen nga buxheti i miratuar i Republikës së Kosovës në përputhje me alokimet buxhetore për

sektorin e bujqësisë dhe procedurat e zbatueshme të Thesarit të Republikës së Kosovës. Me hyrjen në fuqi të buxhetit dhe përmbylljen e kushteve të nevojshme financiare dhe procedurale është krijuar mundësia për procedimin e pagesave të mbetura për përfituesit e programit.

Departamenti për Buxhet dhe Financa në AZhB, në bashkëpunim me Thesarin e Republikës së Kosovës, është obliguar t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e pagesave në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike. Sipas vendimit, Agjencia për



Zhvillimin e Bujqësisë duhet të raportojë te ministri brenda pesë (5) ditëve për përparimin e realizimit të pagesave.

NGA ANA FRANK TE TRENI NAZIST ME AR: MISTERET E LUFTËS SË DYTË, QË ENDE SFIDOJNË HISTORIANËT



Lufta e Dytë Botërore nuk la pas vetëm miliona viktime dhe plagë të pashërueshme në historinë e njerëzimit. Misteret e Luftës së Dytë intrigojnë shumëkënd. Ajo la edhe enigma që, dekada më vonë, vazhdojnë të sfidojnë historianët, hetuesit dhe kërkuesit e thesareve. Kush e tradhtoi Ana Frankun? A ekzistoi vërtet treni nazist i mbushur me ar? Dhe çfarë panë pilotët në qiell gjatë viteve të luftës? Disa nga sekretet më të errëta të atij konflikti mbeten ende pa përgjigje. Ne të gjithë i duam misteret, dhe Lufta e Dytë Botërore siguroi shumë të tilla. Shkalla e madhe e luftimeve dhe e taktikave të tokës së djegur, solli zhdukjen e shumë njerëzve. Në atë kohë u krijuan shumë teknologji të avancuara që humbën gjithashtu nga koha. Përgjigjet mbi këto pyetje u ndanë me të vetmit që i njihnin, dhe zgjidhja e këtyre mistereve ka angazhuar shumë njerëz që nga koha e luftës. Ja cilat janë disa nga misteret më interesante, ende të pazgjidhura nga Lufta e Dytë Botërore.

Objektet misterioze në qiellin e luftës

Objektet fluturuese të paidentifikuara janë shumë të preferuara nga ata që janë të interesuar për misteret. Dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore janë raportuar shumë imazhe të çuditshme ajrore. Objekte të tilla u ndeshën në qiell shumë herë nga pilotët gjatë asaj lufte. Këto objekte ishin në madhësi, forma dhe ngjyra të ndryshme,

madje silleshin ndryshe nga avionët që kishin ndërtuar njerëzit. Në fillim, zyrtarët e ushtrive besonin se këto pamje ishin rezultat i lodhjes fizike të pilotëve apo dukurive atmosferike. Por pas raporteve të vazhdueshme, nisi një hetim zyrtar për të kuptuar se çfarë ishin ato. Ekzistonte frika se këto objekte ishin një teknologji e fshehtë armike, por natyra e tyre në dukje miqësore e bëri të pamundur këtë shpjegim. Hetimet nuk mundën të jepnin asnjë përgjigje, dhe misteri i atyre objekteve mbetet ende sot i pazgjidhur.

Çfarë ndodhi me globin e Hitlerit?

Dihet se Adolf Hitlerit i pëlqenin gjërat e mëdha. Mjafton të shihni tanket që ai dha urdhër të ndërtoheshin gjatë viteve të luftës. Megjithatë, asnjë prej tyre nuk është i rrethuar nga një mister si globi gjigant i udhëheqësit nazist. Ky glob u ndërtua posaçërisht për Hitlerin nga një kompani me qendër në Berlin në vitet 1930. Ajo sferë gjigante mbeti në zyrën e Hitlerit për pjesën më të madhe të jetës së tij, dhe u shndërrua në simbol të ambicieve despotike të Hitlerit. Por pas luftës, vendndodhja e globit mbeti një mister. Disa globe të ngjashëm u ndërtuan në të njëjtën kohë, ndërsa të tjerë dolën në shitje përgjatë dekadave, por asnjë prej tyre nuk është konfirmuar si globi i Hitlerit. Ai mund të jetë shkatërruar në

kaosin e ditëve të fundit të Luftës së Dytë Botërore, ose është grabitur nga një ushtar që e ka mbajtur të fshehur. Historiani Wolfram Pobanz pretendon se Hitleri nuk ishte fans i globit, pasi ai nuk është parë kurrë në një foto me të.

Kush e tradhtoi Ana Frankun?

Ana Frank ishte një nga miliona viktimat e Holokaustit. Por ajo vajzë e re u bë e famshme pas vdekjes, pasi u publikua ditari i saj, që përshkruante në detaje jetën dhe përvojat e fshehjes nga nazistët. Ditari e ka bërë atë një nga figurat më të njohura historike. Për pasojë, çdo moment i jetës së saj është studiuar në thellësi. Por mbetet ende një çështje e pazgjidhur: kush e zbuloi vendndodhjen e saj dhe të familjes? Për këtë janë paraqitur një sërë teorish të ndryshme, që supozohet se i përgjigjen pyetjes, por asnjë provë e fortë nuk është ofruar deri më tani. Disa pyetje janë ngritur mbi fatin e Ana Frankut, por përgjigjet e sakta për to nuk erdhën kurrë. 1. A u tradhtua familja Frank nga dikush që e njihte strehën e tyre? A ishte informatori një person nga rrethi i tyre, apo dikush që kishte dijeni rastësisht për vendin ku fshihehin? 2. A ishte arrestimi rezultat i një hetimi tjetër të nazistëve? Disa historianë kanë sugjeruar se policia mund të ketë hetuar racionet e paligjshme ose tregtinë e zezë, dhe zbulimi i strehës mund të ketë qenë një rastësi.

3. A mund të ketë qenë një punonjës i magazinës ai që njoftoi autoritetet? Në ndërtesën ku fshihej familja Frank punonin disa njerëz. A mund të ketë vënë dikush re lëvizje të pazakonta? 4. A ishte një informator i Gestapos që kërkonte shpërblim? Gjatë pushtimit nazist shumë njerëz raportonin hebrenjtë për para. A ishte rasti i familjes Frank pjesë e këtij fenomeni? 5. A mund të ketë qenë një gabim apo një kontroll rutinë? Disa studiues kanë sugjeruar se policia mund të ketë hyrë në ndërtesë për një arsye tjetër dhe më pas të ketë zbuluar strehën. 6. Pse identiteti i informatorit nuk është provuar kurrë me siguri? Pavarësisht hetimeve të shumta historike dhe gazetarisë investigative, asnjë teori nuk është konfirmuar plotësisht. 7. A do të zbulohet ndonjëherë e vërteta? Me dokumente të reja arkivore dhe analiza moderne historike, disa besojnë se misteri mund të zgjidhet një ditë.


Lista enigmatike e emrave në Aushvic

Në vitin 2009, një historian zbuloi një listë me 17 emra në kampin e përqendrimit të Aushvicit gjatë kryerjes së punimeve rutinë për mirëmbajtjen e këtij objekti. Të gjithë emrat ishin britanikë dhe ishin shkruar në një copë celuloid të bardhë. Tetë nga emrat kanë një shenjë të tyren, kështu që lista është përdorur me siguri për të verifikuar diçka, por gjithçka mbetet ende një mister. Përveç emrave, lista përmban gjithashtu

një varg numrash dhe disa fjalë të zakonshme gjermane me përkthimet e tyre në anglisht, si “që atëherë”, “kurrë” dhe “tani”. Disa shpjegime sugjerojnë se emrat ishin një listë e spiunëve britanikë, apo edhe një listë e trupave britanike që dezertuan tek nazistët.

A ekzistoi vërtet treni nazist me ar?

Ky tren mbetet një nga misteret më të mëdha të Luftës së Dytë Botërore. Ndërsa historia e saktë mund të ndryshojë sipas varianteve që rrëfehen, shumë njerëz besojnë se kur e kuptuan se po e humbnin luftën, nazistët ngarkuan një tren plot me ar, vepra arti dhe sende të tjera me vlerë që ishin grabitur në vendet e pushtuara. Thuhet se ky tren, me gjasë ka përfunduar në ndonjë tunel të kyçur, por nuk është gjetur asnjëherë. Nëse është e vërtetë, atëherë ngarkesa në bordin e këtij treni mund të vlejë shumë para. Edhe pse kjo histori është bërë në thelb një legjendë urbane, ajo është marrë seriozisht nga shumë autoritete që nga viti 1945. Ushtria polake e kërkoi atë tren pas luftës, por pa sukses. Nuk është gjetur asnjë provë që sugjeron se treni ka ekzistuar ndonjëherë. Por disa vite më parë, kërkimi rinisi nga 2 polakë, të cilët pretenduan se kishin marrë një rrëfim nga dikush në shtratin e vdekjes për vendndodhjen e trenit. Gjithsesi, sërish nuk u gjet asnjë tren i ngarkuar me ar.



Hazardi kritikon VAR-in: Po ia zbeh emocionet futbollit

BRUKSEL, 12 MARS - Ish-futbollisti i Chelseat dhe Real Madridit, Eden Hazard, ka shprehur kritika ndaj sistemit të arbitrit me video, VAR, duke thënë se ai po ia zbeh emocionet futbollit. Hazardi ka thënë se do të pëlqente që ky sistem të hiqej nga futbollit pasi, sipas tij, ndërhyrja e

teknologjisë shpesh është duke e prishur spontanitetin e lojës. Ish-sulmuesi belg është shprehur se VAR-i jo vetëm që është duke e zgjatur procesin e vendimmarrjes, por është duke ua prishur momentin e festës futbollistëve dhe tifozëve. Sipas tij, shpesh ndodh që një gol i bukur të

mos festohet menjëherë, pasi lojtarët dhe tifozët duhet të presin disa minuta për të mësuar nëse goli do të pranohet apo jo. Hazardi ka thënë se futbollit gjithmonë ka pasur një element të padrejtësisë, i cili, sipas tij, i jep njëfarë "sharmi" lojës, edhe pse jo gjithmonë është i

pranueshëm për tifozët kur vendimet shkojnë kundër ekipit të tyre. Megjithatë, ai ka pranuar se teknologjia synon ta bëjë lojën më të drejtë, por shtoi se ndërhyrja e saj mund ta largojë dramën dhe spontanitetin që e bëjnë futbollin tërheqës për lojtarët dhe tifozët.

ADEMI TAKON MINISTRIN E SPORTIT, VLERËSOHET PUNA E FFK-SË DHE SUKSESET E ARRITURA

PRISHTINË, 12 MARS - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, së bashku me nënkryetarin Agim Dibrani dhe anëtarin e KE të FFK-së, Samir Ujkani, patën një takim shumë konstruktiv me ministrin e ri të Sportit, Blerim Gashani. Ademi ka thënë se në emër të gjithë komunitetit të futbollit, e ka uruar ministrin Gashani për detyrën e re, teksa ka theksuar se "është mirë për sportin tonë që në krye të këtij dikasteri tashmë kemi një ish-futbollist dhe një pasionant të madh të futbollit". "Ministrin e njoftova për rrugëtimin dhe zhvillimin e Federatës, për organizimin e garave vendore si dhe për punën dhe përfaqësimin e ekipeve tona kombëtare, teksa i shpreha

gatishmërinë e plotë të FFK-së për bashkëpunim të vazhdueshëm, duke qenë se përmes futbollit ne përfaqësojmë dhe promovojmë shtetin tonë në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Ademi në rrjetet sociale. Ai ka thënë se ministri Gashani shprehu kënaqësinë për këtë takim, ndërsa vlerësoi punën e FFK-së dhe përgëzoi për performancën dhe sukseset e arritura. "Ai theksoi se për të sporti nuk është vetëm obligim institucional, por edhe një pasion i veçantë. Ai garantoj se bashkëpunimi me Federatën e Futbollit e Kosovës do të vazhdojë dhe do të forcohet edhe më tej. Si sfidë kryesore për futbollin tonë ritheksuam se



vazhdon të mbetet infrastruktura sportive. Andaj, shprehëm nevojën që Ministria e Sportit të vazhdojë me ritëm të përsheptuar punën për ndërtimin dhe përfundimin e

stadiumeve, të cilat janë jetike për zhvillimin e futbollit dhe për organizimin dinjitoz të ndeshjeve vendore e ndërkombëtare. Ministri na njoftoi se është duke zhvilluar vizita në stadiumet që

janë në ndërtim, e për të cilat konfirmoi se janë prioritet i ministrisë", ka thënë kreu i FFK-së. Sipas tij, morën zotim nga ministri Gashani se nuk do të tolerohen vonesa të pajustificuara, pasi përfundimi i këtyre projekteve është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e sportit dhe për krijimin e kushteve më të mira për futbollin në vend. "Gjatë takimit diskutuam edhe për ndeshjet e radhës të Kombëtares së Kosovës në kuadër të 'play-off'-it për Kupën e Botës 2026, si dhe për rëndësinë e mbështetjes institucionale për organizimin sa më të mirë për këto ndeshje", ka thënë Ademi.

FFK-ja I JEP MBËSHTETJE KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR PROJEKTET INFRASTRUKTURE SPORTIVE

PRISHTINË, 12 MARS - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, At dhe Rama, janë pritur në takim nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi. "Me këtë rast, i përcollëm urimet më të përzemërta z. Ademi për rizgjedhjen e tij në krye të FFK-së, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe suksese të mëtejshme në mandatin e ri për zhvillimin dhe fuqizimin e futbollit në Kosovë", ka thënë kryetari Latifi. Ai ka bërë me dije se gjatë takimit



me theks të veçantë është diskutuar standardizimi i fushave të futbollit në komunën e Rahovecit sipas kriterëve të UEFA-s. "Morëm mbështetje të plotë nga federata për t'i shtyrë përpara këto projekte madhore

që do të transformojnë infrastrukturën sportive në komunën tonë. Ditë të mira po vijmë për sportistët e Rahovecit! Bashkë, po ndërtojmë të ardhmen e sportit tonë", ka thënë Latifi.

PREMI PËR LOJTARËT E POLONISË PARA DUELIT ME SHQIPËRINË

Varshavë, 12 mars - Kombëtarja polake do të garojë për kualifikimin në Kupën e Botës 2026 në mars. Polonia e mirëpret Shqipërinë më 26 mars nga ora 20:45. Tashmë ekipi polak është nxitur me premi të mëdha para duelit me Shqipërinë në "play-off" të Botërorit. Nëse Polonia avancojnë në Kupën e Botës, lojtarët e ekipit kombëtar do të marrin një bonus shumë të madh nga Shoqata Polake e Futbollit (PZPN) - afërsisht 40 për qind të 10.5 milionë dollarëve (rreth 4 milionë euro)



të garantuar që FIFA do t'u paguajë pjesëmarrësve në fazën e grupeve të Kupës së Botës, ka thënë Mateusz Ligeza, një gazetar nga "Radio Zet". Fituesi i duelit Poloni - Shqipëri do të luajë në finalen jashtë fushe kundër Suedisë ose Ukrainës.


Barcelona synon Erling Haalandin

Barcelonë, 12 mars - Një prej kandidatëve për postin e presidentit të Barcelonës, Victor Font, ka bërë një lëvizje të rëndësishme në garën përballë Joan Laportas. Font tashmë ka nisur kontaktet

me Manchester Cityn për ta negociuar transferimin e sulmuesit Erling Haaland në "Camp Nou". Kjo lëvizje do të mund të ketë ndikim të madh në kandidaturën e Fontit, i cili do të bëjë të pamundurën për ta

bindur Cityn për lirimin e sulmuesit norvegjez nëse merr pozitën e presidentit të Barcelonës. Haaland po shihet si përforsim i madh të Barcelonës edhe pse ka kontratë valide me Manchester

Cityn deri në verën e vitit 2034. Barcelona e ka prioritet transferimin e një sulmuesi në afatin kalimtar të verës, duke pasur parasysh se polakut Robert Lewandowski i skadon kontrata dhe do të largohet si lojtar i lirë.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 358/1
Dt. 12.03.2026

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ(MAShT) 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ (MAShT) 07/2017, Rregullores (Qrk) Nr: 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe në paralelet e ndara në Prishtinë dhe Prizren për pozitën mësimdhënës për nivelin e V-të të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASh) ka zhvilluar nivelin e V-të të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”. Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj që menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”. Për këtë gjeneratë kualifikimi “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” do të ofrohet përmes Qendrës së Kompetencës (QeK) Ferizaj në paralelet e ndara: Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” – Prishtinë, Qendrën e Kompetencës në Prizren.

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës në Ferizaj	Ferizaj	Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”	Vend i lirë për një (1) vit shkollor)	2	6.8
SHML	Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi”, në Prishtinë	Prishtinë	Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin“Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”	Vend i lirë për një (1) vit shkollor)	2	6.8
SHML	Qendra e Kompetencës në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin“Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”	Vend i lirë për një (1) vit shkollor)	2	6.8

- I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
 - Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
 - Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:
- Formulari i aplikimit (merret në Agjencinë për AAPAr-së në Prishtinë, ndërtesa MASh-II, kati i tretë, objekti pranë fakultetit ekonomik dhe juridik në Prishtinë).
 - Rezymeja personale (CV);
 - Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
 - Diplomat e kualifikimit (e noterizuara);
 - Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASh;
 - Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MAShT;
 - Dëshmi të përvojës së punës ne arsim (kontratat e punës ose vërtetim);
 - Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MAShT për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit; Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Agjenci të AAPARr-së në Prishtinë me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASh-it: UA Nr. 07/2017, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e të nivelit të V-të
- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master për Arsim gjithëpërfshirës, Master në pedagogji;
 - Kërkesë specifike: Certifikata më të cilën dëshmon se ka përfunduar trajnimin dhe është certifikuar me sukses në programin e PEARSON-MAShT për këtë kualifikim.

IV. Detyrat dhe përgjegjësitë e Mësimdhënësit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”

Mësimdhënësi është përgjegjës për planifikimin, realizimin dhe sigurimin e cilësisë së pjesës teorike të programit në përputhje me standardet e kualifikimit BTEC dhe legjislacionin në fuqi.

Detyrat kryesore

- Realizon planprogramin mësimor në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe aktet nënligjore përkatëse.
- Zbaton programin e kualifikimit duke respektuar standardet më të larta të kualifikimeve BTEC.
- Siguron cilësi dhe kompetencë profesionale në procesin e mësimdhënies dhe të vlerësimit.
- Zbaton metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me standardin e profesionit dhe kërkesat e programit.
- Identifikon dhe mbledh dëshmi nga kandidatët për Njohjen e Mësimi Paraprak (NjMP).
- Propozon dhe koordinon procesin e NjMP në përputhje me procedurat përkatëse.
- Zbaton verifikimin e brendshëm të vlerësimit në përputhje me kërkesat e sigurimit të cilësisë.
- Në koordinim me instruktorin, sistemojnë kandidatët në praktikë profesionale në: institucione parashkollore, institucione edukativo-arsimore, qendra burimore, OJQ relevante.
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale dhe monitoron progresin e tyre.
- Përgatit raporte individuale për kandidatët mbi arritjet në praktikë dhe ndërlihdjen me rezultatet mësimore.
- Përditëson dhe përmirëson vazhdimisht materialet mësimore dhe zhvillon materiale të reja sipas nevojës.
- Merr pjesë në trajnime profesionale të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAPARr, përfshirë projekte të donatorëve.
- Kontribuon në aktivitetet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në Qendrën e Kompetencës.
- Kryen hulumtime profesionale në funksion të përmirësimit të cilësisë së kualifikimit.
- Bashkëpunon me menaxhmentin e Qendrës së Kompetencës dhe partnerët institucionalë për realizimin e praktikës profesionale.
- Respekton linjën e raportimit dhe zbaton detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- V. Vlerësimi i kandidatëve
- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
 - Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
 - Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
 - Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mblihdhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
 - Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
 - Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

- VI. Afati dhe mënyra e aplikimit
- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data **13.03.2026** deri me **11.04.2026**.
 - Formulari për aplikim merret dhe dorëzohet në Agjencinë për AAPAr-së në Prishtinë, ndërtesa MASh-II, kati i tretë, objekti pranë fakultetit ekonomik dhe juridik në Prishtinë;
 - Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
 - Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
 - Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
 - Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me aftësi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 357/1
Datë: 12.03.2026

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 26.01.2026 me nr. 151/26 të **Qendra e Kompetencës Prizren** shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendra e Kompetencës Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të ketë licencën e punës.
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit në Durrës me data të caktuara sipas vendimit nga KDSH-ja (prej 27.04. deri 30.04.2026).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2023-2024-2025)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskurzion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt 27.04.2026 dhe kthimi më dt 30.04.2026
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eksursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Durrës, Krujë, Berat, etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
 - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
 - Menyja
 - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
 - Gjendja teknike e autobusëve
 - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 12:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutjesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndertesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus dy ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është pesë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirlinda Sejday shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Shaban Golaj” Lepavec Gjakovë nga kl. 1-8.

- Muhamet Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Drenica" Polac.

- Sadete Bajrami shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta" Prekaz.

- Fidan Peci shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 5-të të shkollës "Musa Hoti".

- Suna Haxhani shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

- Suzana Halimi shpall të pavlefshme dëftesën e vitit 4-të dhe diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi".

- Neriman Mujka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi" Mitrovicë.

- “Magma Gaming Center” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812029016.

- “Blue” IM 01” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812006907.

- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh. profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

Zejnije Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



CONTRACT NOTICE

SUPPLIES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurementof the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 13/03/2026

Procurement No	Equipment	001	2026	121
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English ☐

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name:Kosovo Humanitarian Charitable Society “Mother Teresa”			
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1			
Town:Pristina	Postal code:10000		Country:Kosovo
Contact point(s):Zef Shala		Telephone:038-542-865	
Email:zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-869	
Internet address (if applicable):		www.motherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Supplies with tools and equipment for 50 beneficiaries for non majority communities		
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Chooseone category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)		
	☐ Supplies	
	Main Place of Delivery As specified by the Contracting Authority.	

II.1.5) Short description of the object of the contract Supplies with tools and equipment for 50 beneficiaries for non majority communities
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000.08
II.1.7)Variants are accepted
II.1.8)Division into lots If yes, tenders may be submitted for (tick one ☐ No ☒ box only) ☒ All lots
II.1.9) In case of one or more Lots (if applicable) The maximum number of Lots that may be awarded to one Economic Operator is: <i>[insert number]</i>

II.1.10) Information about lots (if applicable)	
Sect or No.	Short Description
1	Processing of agricultural products on farms and in household economies
	Cheese vat, plough, tractor mower, motor cultivator, mixer for grinding and mixing animal feed, trailer for motor cultivator, greenhouse, milk cooling tank (lactofriz), tractor corn planter, tractor rotary tiller, tractor sprayer, etc.
2	Non-wood forest products (NWFP), cultivated medicinal and aromatic plants (MAP), mushrooms, and ornamental plants
	Fruit and herb dryer, washing sink for fruits and vegetables, vacuum sealing machine, grain drying oven, mushroom cutting machine, etc.
3	Honey production
	Electric honey centrifuge, honey decrystallizer, honey duplicator (melter), air conditioner (climate unit), glass frames for beehives, beehives, feed mixer for bee cakes, bee knife, bee smoker, beekeeper protective clothing, etc.
4	Poultry farming for egg and meat production
	Automatic feeders for laying hens or broilers, poultry drinking system, incubator, egg nest boxes and egg collection system, etc.
	Further details are provided in the Tender Dossier.
II.1.11) Estimated contract value: 235,000.00 Euro	

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 3 or days 90 (from the contract signature)	
or	
Starting	01/05/2026
Completion	31/07/2026

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	No ☐
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded(if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No ☐

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1)Eligibility Requirements: 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration Certificate 3. VAT Certificate (if applicable) Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. License Registration Certificate. 2. List of employees, including professional and administrative staff, with individual CVs. 3. Copies of reference letters or copies of contracts, along with a list of similar implemented projects. Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Certificate issued by the competent judicial authority confirming that the company and its legal representative are not involved in any legal proceedings (required only for the awarded company). 2. Company profile. 3. Tax Verification Certificate issued by the Tax Administration of Kosovo confirming that the company has fulfilled its tax obligations (required only for the awarded company). 4. Bank Certificate confirming that the company holds an active bank account (required only for the awarded company). Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity Documentary evidence required Copy of documentary

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No ☐
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the supplies	
	Yes ☐

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure	
☐ Open	

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price meeting the Eligibility Criteria and Required Documentation
--

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No ☐
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests fortender dossier: date from 18/03/2026 until 27/03/2026 Payable documents	
	No ☐
IV.3.3) Time limit for receipt oftender: Date20/04/2026time14:00place Office of Mother Teresa Society Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission oftender ☐ no	
IV.3.5) Is tender security needed:	No ☐
IV.3.6) Tender validity period: date:20/04/2026 days 30 or months 1-one	
IV.3.7)Tenderopening meeting: Date20/04/2026time14:30place MTS Office Prishtina	

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092,at the address specified in Section I of this Contract notice.
--

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in English.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

